



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

УСТАВНИ СУД

CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 27 Tetor 2016
Nr. ref.:RK983/16

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI149/15

Parashtrues

Savo Lekić, Dimitrije Lekić dhe Branislav Lekić

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme,
Rev. nr. 148/2014, të 2 qershorit 2015**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është paraqitur nga z. Savo Lekić, z. Dimitrije Lekić dhe z. Branislav Lekić (në tekstin e mëtejme: parashtruesit), të përfaqësuar nga z. Živojin Jokanović, avokat nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesit kërkojnë vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 148/2014, të 2 qershorit 2015.
3. Aktvendimi i kontestuar u është dorëzuar parashtruesve më 31 gusht 2015.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, i cili siç pretendohet, shkel të drejtat e parashtruesve të kërkesës, të garantuara me nenet 3 [Barazia para Ligjit], 24 [Barazia para Ligjit] dhe 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 22 dhjetor 2015, parashtruesit e dorëzuan kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 22 janar 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Snezhana Botusharova gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Bekim Sejdiu.
8. Më 29 shkurt 2016, Gjykata i njoftoi parashtruesit për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
9. Më 14 shtator 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës në përbërje e plotë, papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Parashtruesit e kërkesës janë në lidhje familjare; gjyshi i të cilëve sa ishte gjallë, më saktë në vitin 1946, lidhi kontratën për ndarje dhe shpërndarje të pasurisë, me të cilën djemve të tij (përndryshe, paraardhësve të parashtruesve të kërkesës) ua ndau pasurinë e tij të patundshme në mënyrë të paraparë me kontratën e lartpërmendur për ndarje dhe shpërndarje të pasurisë.
11. Gjyshit të parashtruesve të kërkesës, më 11 shtator 1947, me Aktgjykimin [K. nr. 570/47] të Gjykatës së Rrethit në Prishtinë i është konfiskuar prona e paluajtshme dhe e luajtshme e cila ka qenë objekt i Kontratës për ndarjen dhe shpërndarjen.

12. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për kthimin e pronës së konfiskuar, prona e paluajtshme e konfiskuar me Aktgjykimin [K. nr. 570/47] të Gjykatës së Rrethit në Prishtinë u është kthyer trashëgimtarëve juridik, siç ishte paraparë me Kontratën për ndarje dhe shpërndarje, të vitit 1946. Meqenëse, në ndërkohë, pronari i pronës së paluajtshme (gjyshi i parashtruesve të kërkesës) kishte vdekur, parashtruesit e kërkesës në vitin 1995 kanë paraqitur në Gjykatën Komunale në Prishtinë kërkesën për vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi bazën e trashëgimisë mbi pasurinë e paluajtshme të konfiskuar me Aktgjykimin [K. nr. 570/47] të Gjykatës së Rrethit në Prishtinë, me atë që me rastin e vërtetimit të së drejtës pronësore mos të merret parasysh Kontrata për ndarje dhe shpërndarje e vitit 1946, sepse me këtë Kontratë ishte paraparë që paraardhësit juridik të parashtruesve të kërkesës i takonte një pjesë më e vogël se sa trashëgimtarëve të tjerë.
13. Më 23 prill 1997, Gjykata Komunale në Prishtinë me Aktgjykimin [P. nr. 1595/95] vërtetoi se paluajtshmëria e kontestuar në momentin e konfiskimit, edhe pse në librat kadastrale ishte e evidentuar mbi paraardhësin juridik të parashtruesve, ajo faktikisht nuk ishte pronësi e tij ekskluzive, pasi që paluajtshmëria kontestuese me Kontratën për ndarje, e vitit 1946, u është shpërndarë djemve të tij.
14. Më 5 dhjetor 1998, Gjykata e Qarkut në Prishtinë me Aktgjykimin [Gzh. nr. 901/98] vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë.
15. Në një datë të pacaktuar në vitin 2005, parashtruesit e kërkesës paraqitën padinë për vërtetimin e pronësisë mbi trashëgiminë e paraardhësit juridik të parashtruesve të kërkesës në Gjykatën Komunale në Prishtinë.
16. Gjykata Komunale në Prishtinë [me Aktvendimin, C. nr. 209/2009] hodhi poshtë padinë e parashtruesve si të palejueshme, për shkak se për këtë çështje tashmë kishte vendosur [me Aktgjykimin P. nr. 1595/95, të 23 prillit 1997] Gjykata Komunale në Prishtinë. Gjykata e Qarkut në Prishtinë [me Aktvendimin Gzh. nr. 508/2009] vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale.
17. Më 12 mars 2009, parashtruesit e kërkesës paraqitën përsëri padinë në Gjykatën Komunale në Prishtinë. Gjykata Komunale në Prishtinë [me Aktvendimin P. nr. 521/09] hodhi poshtë padinë e parashtruesve si të palejueshme pasi që vërtetoi se kjo çështje është gjë e gjykuar në formë të prerë.
18. Më 15 tetor 2014, Gjykata e Apelit [me Aktvendimin Ac. nr. 4750/2012] vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë.
19. Më 2 qershor 2015, Gjykata Supreme [me Aktvendimin Rev. nr. 148/2015] vërtetoi vendimet e gjykatave të instancës më të ulët se kjo çështje tashmë është vendosur me Aktgjykimin [P. nr. 1595/95] e Gjykatës Komunale në Prishtinë, të 23 prillit 1997.

"[...] Janë të pasakta pretendimet e revizionit për ekzistimin e dy bazave juridike, respektivisht dy kontesteve të ndryshme, i pari në të cilin paditësit kërkojnë vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi bazën e

trashëgimisë, e në bazë të Certifikatës mbi të drejtat e pronës së paluajtshme UL-71914058-0025 ZK Preoc e cila evidentohet në emër të të ndjerit Nikola Lekić nga fshati Preoc, dhe kontesti i dytë në bazë të aktgjyqimit të plotfuqishëm të paraardhësit juridik të paditësve të cilët kanë kërkuar vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi ngastrat kontestuese në bazë të trashëgimisë, në 1/5 të pjesës ideale të paluajtshmërisë në fjalë. Është fakt që këtu bëhet fjalë për bazën e njëjtë juridike, d.m.th. për vërtetimin e të drejtës së pronësisë mbi bazën e trashëgimisë. [...]

Janë shumë të qarta dhe të përmbledhura qëndrimet e gjykatave të instancës më të ulët se kjo çështje është gjë e gjykuar në formë të prerë. [...].”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesit e kërkesës pretendojnë se vendimi i kontestuar është në kundërshtim me nenet 3 [Barazia Para Ligjit], 24 [Barazia Para Ligjit] dhe nenin 46 [Mbrotja e Pronës] të Kushtetutës.

21. Parashtruesit e kërkesës gjithashtu pretendojnë:

“Thelbi i kërkesës është që të vlerësohet kushtetutshmëria dhe ligjshmëria e Aktvendimit kontestues, si aktvendimit përfundimtar, si dhe që kjo Gjykatë të vërtetojë dhe të aprovojë kërkesën, të vërtetojë shkeljen e Kushtetutës dhe ligjit, si dhe që në dëm të parashtruesve të kërkesës është shkelur e drejta e tyre e garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, gjithashtu se: Gjykata Supreme e Kosovës dhe të dyja gjykatat e instancës më të ulët i kanë shkelur të drejtat e paditësve dhe i kanë bazuar aktvendimet e tyre mbi qëndrimin dhe të kuptuarit të paqëndrueshëm juridikisht.”

22. Parashtruesit e kërkesës më tej, theksojnë:

“Prandaj, konsiderojmë se pavarësisht asaj se është fjala për paluajtshmërinë e njëjtë, kemi të bëjmë me bazën e ndryshme juridike. Në rastin e parë – të gjykuar është kërkuar pronësia mbi disa pjesë të pronës, ndërsa në këtë rast kërkohet që gjykata në bazë të provave dhe fakteve të pakontestueshme dhe gjendjes juridike të pakontestueshme të vërtetojë me aktgjykim se toka e kthyer përbën trashëgiminë e të ndjerit Nikola Lekić, ish nga fshati Preoc.”

23. Parashtruesit e kërkesës kërkojnë nga Gjykata:

“[...] që prona e cila është konfiskuar nga paraardhësi i tyre juridik, dhe e cila tani është kthyer, të kthehet në masën trashëgimore të qytetarit, tani të ndjerit Nikola Lekić në trashëgiminë e tij, ndërsa çështja e së drejtës për këtë pronë të zgjidhet në procedurën e përcaktuar për këtë çështje.”

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata së pari vlerëson nëse kërkesa e parashtruesve i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.

25. Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

26. Gjykata thekson edhe nenin 48 të Ligjit, i cili përcakton:

„Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

27. Gjykata i referohet edhe rregullit 36 të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese;

[...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

28. Gjykata rikujton se parashtruesit e kërkesës pretendojnë se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme dhe aktgjykimet e gjykatave të rregullta i shkelin të drejtat e tyre për barazi para ligjit dhe mbrojtjen e pronës.

29. Gjykata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kanë ofruar asnjë arsyetim procedural ose material në kërkesën e tyre. Ata vetëm i përmendin disa nene të Kushtetutës, pa dhënë shpjegime të mëtijshme në lidhje me atë se si ka ndodhur shkelja e pretenduar.

30. Fakti që parashtruesit e kërkesës nuk pajtohen me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të Kushtetutës (Shih, rastin *Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, Nr. 5503/02, GJEDNJ, Aktgjykim i 26 korrikut 2005).

31. Gjkata, gjithashtu, vëren se Gjkata Supreme refuzoi kërkesën e parashtruesve për revizion dhe mbështeti arsyetimin e Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Themelore.
32. Për më tepër, Gjkata vëren se Gjkata Supreme e shqyrtoi secilin pretendim të parashtruesve të kërkesës duke shpjeguar në mënyrë të detajuar, për ç'arsye është dashur që kërkesa e parashtruesve për revizion të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i gjykatës së instancës më të ulët.
33. Gjkata në bazë të shkresave të lëndës vërtetoi se me Aktgjykimin e Gjykatës Supreme nuk janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë, siç pretendojnë parashtruesit e kërkesës.
34. Sa i përket kërkesës së parashtruesve për vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit kontestues, Gjkata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve ose të ligjit (ligjshmërisë), që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta ose organet shtetërore, përveç dhe për aq sa ato mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë të mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria).
35. Gjkata gjithashtu thekson se nuk vepron si gjykatë e shkallës së katërt në lidhje me vendimet që merren nga gjykatat e rregullta apo nga autoritetet tjera publike. Është roli i gjykatave të rregullta apo autoriteteve tjera publike, që të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, *mutatis mutandis*, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, nr. 30544/96, paragrafi 28, GJEDNJ, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28).
36. Gjkata Kushtetuese mund vetëm të shqyrtojë nëse procedurat në përgjithësi dhe të shikuara në tërësinë e tyre, janë kryer në mënyrë të tillë sa që parashtruesit e kërkesës të kenë pasur gjykim të drejtë (Shih, *inter alia*, *Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 13071/87, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut, i 10 korrikut 1991).
37. Gjkata më tej, konsideron se procedurat në gjykatat e rregullta, duke përfshirë edhe ato në Gjykatën Supreme, kanë qenë të drejta dhe të arsyetuara (Shih, *mutatis mutandis*, *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, GJEDNJ, vendimi i 30 qershorit 2009).
38. Gjkata vëren se parashtruesit e kërkesës nuk kishin dorëzuar asnjë dëshmi *prima facie* që do të tregonte shkeljen e të drejtave sipas Kushtetutës (Shih, *Vanek kundër Republikës së Sllovakisë*, nr. 53363/99, GJEDNJ, Vendim i 31 majit 2005) dhe nuk kishin saktësuar se si nenet e përmendura të Kushtetutës e mbështesin pretendimin e tyre në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës dhe nenin 48 të Ligjit.
39. Si përmbledhje, Gjkata përfundon se pretendimet e parashtruesve të kërkesës për shkelje të të drejtave dhe lirive të tyre janë të pabazuara dhe se nuk janë të dëshmuara. Prandaj, kërkesa e tyre duhet të deklarohet e papranueshme, si qartazi e pabazuar.

40. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar dhe e papranueshme në pajtim me Kushtetutën dhe rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës,

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe me rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 14 shtator 2016, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Snezhana Botusharova



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi